

dt. 16/06/2021

Akt Themelimi

I shoqerise tregtare "THERANA-B F" sh.p.k

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise, te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008, "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare, me vullnetin e tij te lire, te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi ne ortaket :

- 1- Klesta Kukunja, person fizik, banues ne Tirane, i identifikuar me ID me nr: I85218068V
 - 2- Flamur Kaimi, person fizik, banues ne Tirane, i identifikuar me ID me nr: F90127163R
- vendosim te krijojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar "THERANA-B F" sh.p.k me akt themelimi si vijon :

Neni 1

Formulimi

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur "THERANA-B F" sh.p.k. Shoqeria do t'i nenshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqeria do te ushtrje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Selia e Shoqerise

Selia e shoqerise tregtare private do te jete ne Tirane, Sheshi Avni Rustemi Nr. 37, Shk. 1, Ap. 2. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise .

Neni 3

Objektivi I Veprimtarise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitete ne fushen e:

Akt Themelimi THERANA-B F shpk

Ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime civile, industriale turistike, bujqësore deri në 5 kate.

Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore mbi 5 kate, rikonstruksione, ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.

Ndërtime rrugore, ndërtim rruge kategoria IV dhe V, ndërtim rruge kategoria III dhe II.

Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim autostrade -pista -aeroporte helioporte.

Ndërtim hekurudhore, punime hekurudhore, punime speciale të shinave dhe traversave, punime në sistemin elektrik dhe të sinjalizimit.

Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m, ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 m -Ekstakada-ura metalike -të varura, ndërtim tunele rrugore - hekurudhore, ndërtime detare, ndërtime portuale -bankina - basene - pontile, punime thellimi-drenimi. Ndërtime hidraulike e hidroteknike, ndërtime ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje, punime mbrojtje të sistemit hidraulik- çimentime etj, ndërtim impiante të sistemit të ujit, ndërtim vajsjellës, gazsjellës, naftësjellës, ndërtim digadamba deri në 10 m, ndërtim galeri- tunele, ndërtim diga të larta.


Vepra të veçanta punime speciale, sillose, kulla, kulla uji etj, B/arme metalike, përforcime themeli e punime nëntokësore, izolime mbi dhe nëntokësore nga ujrat, themele të vecanta, puse shpime gjeologo- inxhinierike, çpime për ujë.

Punime restaurimi, restaurim i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike.

Punime karpenterie.

Punime shërbimi, punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe -pyll parqe, pastrimi i sipërfaqeve urbane, kryerja e punimeve dhe shërbesat funerale, mirëmbajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane -ndriçimi e sinjalizimi urban.

Akt Themelimi THERANA-B F shpk



Shfrytëzim të mineraleve të grupit 1, 11, 111, 1V, në karrierën e punimeve nëntokësore, përdorimin civil të lëndëve plasëse në objektet që punon, nxjerrjen dhe përpunimin e gurit gëlqeror duke prodhuar të gjitha llojet e rërave të suvatimit, etj.

Prodhim, përpunim, ruajtje konservim dhe paketim të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Gumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme përfshirë mbetjet spitalore dhe ato të rrezikshme.

Ndërtim i linjave të shfrytëzimit dhe pasurimit të ujit të pijshëm si dhe tregtimit të tij.

Shërbime pastrimi të ambienteve të brendshme dhe të jashtme dhe shërbime DDD (Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) si dhe tregtim materialesh pastrimi.

Krijimin e stacioneve komplekse të servisit për të gjitha llojet e shërbimeve riparim të automjeteve të ndryshme, larje dhe pastrim mjetesh motorike; rregullime dhe lyerje me bojë, ndërtimi i stacioneve të furnizimit me karburant, pastrim larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve, magazinim dhe trajtim i mbetjeve të ujerave të zeza urbane, tregtimin e materialeve të ndërtimit të prodhuara nga shfrytëzimi përpunimi dhe prodhimi i burimeve minerale, mermereve, graniteve gur dekorativ etj.


Prodhim asfalti, prodhim betoni, prodhim parafabrikate betoni.

Projektim në fushën e ndërtimit. Veprimtari e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis. Auditim mjedisor.

Shitje-blerje automjeteve, autovetura, eskavator, kamiona, kamioncina, import-eksport, makineri te renda etj.

Real-Estate Ndermjetesim per transaksione me pasuri te paluajtshme. Administrim dhe menaxhim prone. Shit-blerje e pasurive te paluajtshme. Dhenie me qira. Vleresim te pasurive te paluajtshme. Marketing. Te tjera dhe te ngjashme. Shitje, blerje, dhenie dhe marrje me qira te pasurive te luajtshme, këshillim financiar dhe juridik në këtë fushë. Sigurimi i kolateraleve dhe garancive për palët e treat që mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Akt Themelimi THERANA-B F shpk



Eksport – import, tregti me shumice e pakice te mallrave industriale, ushqimore, makineri e pjese kembimi te te gjitha llojeve, paisje elektrike, hidraulike, hidrosanitare, lende te para, materiale ndertimi, inerte, produkte te gateshme e gjysem te gateshme, konfeksione, duralumin, paisje elektroshtepiake, etj..

Shërbime call center dhe contact center për klientë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Shërbime marketingu jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet telefonit dhe internetit. Projektim dhe realizim i fushave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumentave të tjera të marketingut nëpërmjet internetit për tu shitur ekskluzivisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shërbime këshillimi në fushën e financave e të tregëtimit të obligacioneve, duke investuar vetë dhe duke gjetur investitor të tjerë apo duke bashkëpunuar me kompani të tjera brenda ose jashtë vendit, ortakë ose jo, për tregëtimin dhe emetimin e letrave me vlerë apo titujve financiarë me transaksione bankare, sipas ligjit.

Organizimin e kurseve të formimit profesional, të trajtimeve të ndryshme në fushën e tregëtimit online nëpërmjet internetit por edhe në fushë të përgjithshme.

Marrje dhe/ose dhënie të pasurive të paluajtshme dhe/ose të luajtshme me qira.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë është 100.000 leke i përbërë nga 2 kuota dhe zotërohet nga ortakët e shoqërisë si më poshtë :

Ortaku Themelues: Flamur Kaimi, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 67.000 Leke, e cila përfaqëson 67 % të kapitalit të shoqërisë,

Ortaku Themelues: Klesta Kukunja, zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 33.000 Leke, e cila përfaqëson 33 % të kapitalit të shoqërisë.

Vlera totale e Kapitalit të Regjistruar 100.000 Leke

Vlera Totale e Kapitalit të Paguar 100.000 Leke, është paguar nga ne, ortakët.

Akt Themelimi THERANA-B F shpk

Neni 6

Drejtimi i Shoqerise

Shoqeria do te drejtohet nga administrator Flamur Kaimi i cili eshte perfaqesuesi ligjor i saj. Administratori eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj.

Cdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme .

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakeve te shoqerise.

Neni 8

Ortaket themelues te shoqerise kane te drejte te emerajne dhe administratore te tjere te vlerave materiale. Kane te drejte te caktojne financiere , likuidatore per problemet e shoqerise si dhe te pajtojne persona te tjere si ortake .

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqiptar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Tirane

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjo shoqeri .

Akt Themelimi THERANA-B F shpk

Neni 12


Akti I themelimit u perpilua ne 4 kopje , per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise "THERANA-B F" sh.p.k

Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaket e shoqerise .


Ortaket Themelues Te Shoqerise

"THERANA-B F" sh.p.k

Klesta Kukunja



Flamur Kaimi



STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"THERANA-B F-B F" sh.p.k.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA

Neni 1

Krijimi

Sot me date 16/06/2021, ne ortaket, dhe kemi krijuar nje shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin. (me poshte e quajtur" Shoqeria").

Neni 2

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetete ne fushat ne vijim:

Ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime civile, industriale turistike, bujqësore deri në 5 kate.

Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore mbi 5 kate, rikonstruksione, ndërtim banese me skelet mbi 8 kate.

Ndërtime rrugore, ndërtim rruge kategoria IV dhe V, ndërtim rruge kategoria III dhe II.

Punime të mirëmbajtjes dhe sinjalizimit në rrugë, ndërtim mbi shtresa rrugore. Ndërtim autostrade -pista -aeroporte heliopoarte.

Ndërtim hekurudhore, punime hekurudhore, punime speciale të shinave dhe traversave, punime në sistemin elektrik dhe të sinjalizimit.

Ndërtim ura dhe vepra arti deri në 10 m, ndërtim ura dhe vepra arti mbi 10 m -Ekstakada-ura metalike -të varura, ndërtim tunele rrugore - hekurudhore, ndërtime detare, ndërtime portuale -bankina - basene - pontile, punime thellimi-drenimi. Ndërtime hidraulike e hidroteknike, ndërtime ujësjellës, kanalizime, kanale e impiante vaditje, punime mbrojtje

të sistemit hidraulik- çimentime etj, ndërtim impiante të sistemit të ujit, ndërtim vajsjellës, gazsjellës, naftësjellës, ndërtim digadamba deri në 10 m, ndërtim galeri- tunele, ndërtim diga të larta.

Vepra të veçanta punime speciale, sillose, kulla, kulla uji etj, B/arme metalike, përforcime themeli e punime nëntokësore, izolime mbi dhe nëntokësore nga ujrat, themele të vecanta, puse shpime gjeologo- inxhinierike, çpime për ujë.

Punime restaurimi, restaurim i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi në vepra arkeologjike.

Punime karpenterie.

Punime shërbimi, punime në sipërfaqe të gjelbërta parqe -pyll parqe, pastrimi i sipërfaqeve urbane, kryerja e punimeve dhe shërbesat funerale, mirëmbajtja dhe zhvillimi i dekorit në mjedise urbane -ndriçimi e sinjalizimi urban.

Shfrytëzim të mineraleve të grupit 1, 11, 111, 1V, në karrierën e punimeve nëntokësore, përdorimin civil të lëndëve plasëse në objektet që punon, nxjerrjen dhe përpunimin e gurit gëlqeror duke prodhuar të gjitha llojet e rërave të suvatimit, etj.


Prodhim, përpunim, ruajtje konservim dhe paketim të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Gumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme përfshirë mbetjet spitalore dhe ato të rrezikshme.

Ndërtim i linjave të shfrytëzimit dhe pasurimit të ujit të pijshëm si dhe tregtimit të tij.

Shërbime pastrimi të ambienteve të brendshme dhe të jashtme dhe shërbime DDD (Dizinfektim, Dizinsektim, Deratizim) si dhe tregtim materialesh pastrimi.

Krijimin e stacioneve komplekse të servisit për të gjitha llojet e shërbimeve riparim të automjeteve të ndryshme, larje dhe pastrim mjetesh motorike; rregullime dhe lyerje me bojë, ndërtimi i stacioneve të furnizimit me karburant, pastrim larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve, magazinim dhe trajtim i mbetjeve të ujerave të zeza urbane,



tregtimin e materialeve të ndërtimit të prodhuara nga shfrytëzimi përpunimi dhe prodhimi i burimeve minerale, mermereve, graniteve gur dekorativ etj.

Prodhim asfalti, prodhim betoni, prodhim parafabrikate betoni.

Projektim në fushën e ndërtimit. Veprimtari e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis. Auditim mjedisor.

Shitje-blerje automjesh, autovetura, eskavator, kamiona, kamioncina, import-eksport, makineri te renda etj.


Real-Estate Ndermjetesim per transaksione me pasuri te paluajtshme. Administrim dhe menaxhim prone. Shit-blerje e pasurive te paluajtshme. Dhenie me qira. Vleresim te pasurive te paluajtshme. Marketing. Te tjera dhe te ngjashme. Shitje, blerje, dhenie dhe marrje me qira te pasurive te luajtshme, këshillim financiar dhe juridik në këtë fushë. Sigurimi i kolateraleve dhe garancive për palët e treat që mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

Eksport – import, tregti me shumice e pakice te mallrave industriale, ushqimore, makineri e pjese kembimi te te gjitha llojeve, paisje elektrike, hidraulike, hidrosanitare, lende te para, materiale ndertimi, inerte, produkte te gateshme e gjysem te gateshme, konfeksione, duralumin, paisje elektroshtepiake, etj..

Shërbime call center dhe contact center për klientë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Shërbime marketingu jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet telefonit dhe internetit. Projektim dhe realizim i fushave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshirë marketingun telefonik dhe instrumentave të tjera të marketingut nëpërmjet internetit për tu shitur ekskluzivisht jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Shërbime këshillimi në fushën e financave e të tregëtimit të obligacioneve, duke investuar vetë dhe duke gjetur investitortë tjerë apo duke bashkëpunuar me kompani të tjera brenda ose jashtë vendit, ortakë ose jo, për tregëtimin dhe emetimin e letrave me vlerë apo titujve financiarë me transaksione bankare, sipas ligjit.

Organizimin e kurseve të formimit profesional, të trajtimeve të ndryshme në fushën e tregëtimit online nëpërmjet internetit por edhe në fushë të përgjithshme.



Marrje dhe/ose dhënie të pasurive të paluajtshme dhe/ose të luajtshme me qira.

Neni 3

Selia

Shoqeria ka seline ligjore ne Tirane, Sheshi Avni Rustemi Nr. 37, Shk. 1, Ap. 2. Transferimi i selise brenda te njejtës Bashki mund te vendoset nga organi administrativ dhe nuk do te sjelle modifikimin e statutit. Me vendim te Organit administrativ, shoqeria mund te krijojë dhe suprimojë agjensi, zyra dhe filiale edhe tjeterkund nderkohe qe per krijimin dhe suprimimin e tyre jashte shtetit, krijimin e selive sekondare si ne Shqiperi dhe jashte saj si dhe per transferimin e selise se shoqerise ne rrethe te tjera, eshte e nevojshme vendimarrja e ortakeve ne mbledhje te asamblese.

Neni 4

Kohezgjatia

Shoqeria do te zhvillojë aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali i shoqerise eshte 100.000 leke i perbere nga 2 kuota dhe zoterohet nga ortaket e shoqerise si me poshte :

Ortaku Themelues: Flamur Kaimi, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 67.000 Leke, e cila perfaqeson 67 % te kapitalit te shoqerise,

Ortaku Themelues: Klesta Kukunja, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 33.000 Leke, e cila perfaqeson 33 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar 100.000 Leke

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar 100.000 Leke, eshte paguar nga ne, ortaket.

Statuti i THERANA-B F-B F shpk

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta).

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe i rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, ka te drejte t'i kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar. si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave. Kjo e drejte parashkruhet brenda 3 vjeteve nga casti i cenimit.

Neni 6

Kerkesa per te paguar Kuota dhe terheqja e kuotave te papaguara

Administratoret mund t'u kerkojne ortakeve te shoqerise pagesen e kontributeve te pashlyera ne lidhje me kuotat e tyre dhe cdo ortak pas marrjes se njoftimit prej 10 diteve i paguan shoqerise shumen per kuotat e zoteruara. Njoftimi per pagese mund te parashikoje dhe pagesen me keste te kontributeve te papaguara. Personit te cilit i drejtohet njoftimi per pagesen e kontributit do te jete pergjegjes per njoftimet qe i drejtohen atij pavarsisht kalimit te mepasshem te pronesise se kuotave me te cilet lidhet njoftimi per pagese.

Zoteruesit e perbashket te nje kuote do te jene pergjegjes bashkarisht dhe ne menyre solidare per shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit te mesiperem.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufzuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fiitohen apo kalohen nepernjete:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise,;
- d) dhurimit,
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.



Ky statut kushtezon kalimin e kuotave te treteve jashte shoqerise, me miratimin e shoqerise dhe te drejten e parablerjes ne favor te shoqerise apo te ortakeve te tjere, sipas modaliteteve dhe shumices se cilesuar qe kerkon ndryshimi i statutit.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 to ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Komhetare te Regjistrimit. Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenskrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne to njejtat kushte qe kerkohen per ndrshimin e statutit. Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejtin mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet Qendres Kombetare te Regjistrimit per regjistrim nga administratori ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723 date 03.5.2007"Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".


KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.



Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- d) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- f) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese
- m) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.


Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme. e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 10

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepernjete nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik



duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjes e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 11

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme. asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit te permendur me larte, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 12

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, miratimin e bilancit. kontrollin e llogarive, miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese, riorganizimin, bashkimin ose ndarjen e shoqerise, shnderimin ne nje forme tjeter, transferimin e kuotave, emerimin e eksperteve dhe likuidatoreve dhe prishjen e shoqerise, zhvillon mbledhje te jashtezakonshme, te cilat jane te vlefshme kur ne te jane te pranishem ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave te kapitalit te shoqerise te cilet votojne me shkrese apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 to nenit 88 te ligjit 9901 date 14.04.2008 dhe merren vendime te vlefshme me votimin pro te $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjese-marres.



Asambleja e pergjithshme vendos me shumicën e votave te ortakeve pjese marres, kur ne te marrin pjese ortaket me te drejte vote te cilet zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave per ceshtje te tjera si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise:
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve:
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar:
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

KREU IV

ADMINISTRATORET

Neni 13

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator.

Administrator i shoqerise eshte **Z. Flamur Kaimi**, lindur me 27.01.1979 ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i dokument identifikimit nr. 037256706, i cili do te ushtroje detyrat e administrimit sipas statudit dhe ligjit per nje periudhe 5 vjecare me te drejte riprteritje. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti, apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Pervec kesaj, administratoret shkarkohen nga gjykata per shkeje te ligjit me kerkese te cdonjerit prej ortakeve. Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe cdo ndryshim i tyre njoftohen per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person jashte ortakerise.

Neni 14

Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.
- e) krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f) kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- g) raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare.

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e asamblese se ortakeve edhe ne rastet kur sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj propozon te bleje nga nje ortak pasuri qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, si perpara Bankave te te gjitha niveleve, per te kryer derdhje, terheqje, transferta etj, perpara Zyrave te Tatim



Taksave, Zyrrave te Qeverisjes Vendore, Zyrrave te Punes, Autoriteteve Doganore etj, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj.

Neni 15

Pergjegjesite

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit to shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin deme shoqerise i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.


Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" administratori detyrohet:

1.

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;
- c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet per te cilat merret vendim;
- d) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit prezent apo te mundshem te interesave personale me ato te shoqerise;
- e) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratori vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standardet profesionale sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga



kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me te kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tij ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara.

Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne te, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara nese ne kundershtrim me dispozitat e ligjit , Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e meposhtme:

- a) u kthen ortakeve kontributet;
- b) a paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c) u shperndan aktivet shoqerise;
- d) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per to shlyer detyrimet
- e) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Neni 16

Viti financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Neni 17

Bilanci i shoqerise dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar mbledhja e ortakeve miraton bilancin e paraqitur nga administratori/et. Mbledhja e ortakeve vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar sic edhe parashikohet nga ligji.



Neni 18

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Neni 19


Te ardhurat neto (dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi te ortakeve.

Neni 20

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"
- e) me vendim te gjykates.

Ne kete rast ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper"



Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise pagueuse me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates per te caktuar nje likuidues.

Neni 21

Likuiduesi merr persiper te drejtat dhe detyrimet e administratoreve nga data e emerimit te tij.

Nese shoqeria emeron me shume se nje likuidues, pervecse kur akti i emerimit parashikon se ata veprojne vecmas njeri-tjetrit, likuiduesit i ushtrojne bashkarisht te drejtat e detyrimet sipas ketij ligji. Likuiduesit mund te autorizojne njerin prej tyre qe te kryejne veprime te nje kategorie te posacme.

Kufizimet e tagrave te likuiduesve u drejtohen te treteve, ne perputhje me percaktimet e ligjit.

Likuiduesi i nenshtrohet mbikeqyrjes se ortakut/eve dhe administratorit/eve.

Neni 22


Te drejtat dhe detyrimet e likuiduesit

Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve duke respektuar radhen e referimit, sipas nenit 605 te Kodit Civil.

Likuiduesi mund te kryejne edhe veprime te reja tregtare per mbylljen e nje veprimi te paperfunduar.

Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare " likuiduesit verejne se pasuria e shoqerise tregtare, perfshire kontributet e pashlyera nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen te pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkejne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se shoqerise ne rastin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne rastin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit likuiduesi pergatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore te shoqerise.



Bilancet ne shoqerine kolektive dhe komandite miratohen nga ortaket e tjere, ndersa ne shoqerite aksionare apo nga ato me pergjegjesi te kufizuar miratohen nga asambleja e pergjithshme.

Neni 23

Perfundimi i likuidimit

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon cregjistrimin e shoqerise, ne perputhje me seksionin V te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

Neni 24

Bashkimi

Dy ose me shume shoqeri mund te bashkohen nepermjet:

1. Kalimit te te gjitha aktiveve e pasiveve te njerës ose me shume prej shoqerive, qe quhen shoqerite e perthithura te nje shoqeri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqeria perthithese, ne kembim te aksioneve apo kuotave te kesaj shoqerie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.
2. Themelimit te nje shoqerie te re, tek e cila kalohen te gjitha aktivet e pasivet e shoqerive ekzistuese, qe bashkohen ne kembim te aksioneve apo kuotave te shoqerise se re. Ky proces quhet bashkim me krijim i nje shoqerie te re.


Neni 25

Ndarja

Nje shoqeri mund te ndahet me vendim te asamblese se ortakeve duke transferuar te gjitha aktivet e pasivet e veta ne favor te dy ose me shume shoqerive ekzistuese apo te themeluara rishtazi. Shoqeria qe ndahet, vleresohet e prishur.

Per ndarjen e shoqerise zbatohen perkatesisht dispozitat e neneve 216 deri ne 225 te ligjit 9901 date 14.04.2008.

Shoqerite, qe fitojne pasurite e shoqerise qe ndahet quhen shoqeri pritesë dhe pergjigjen ne menyre solidare per detyrimet e kesaj te fundit.



Regjistrimi i ndarjes se shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ka si pasoje:

- a) kalimin tek shoqerite pritesese te te gjitha aktiveve e pasiveve te shoqerise qe ndahet, ne perputhje me raportin e ndarjes, te percaktuar ne marreveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja per maredheniet ndermjet shoqerive si dhe per palet e treta;
- b) berjen e aksionareve/ortakeve te shoqerise qe ndahet aksionare apo ortakeve te nje ose me shume shoqerive pritesese, ne perputhje me raportin e ndarjes, percaktuar ne marreveshjen e ndarjes.
- c) vleresimin e shoqerise qe ndahet si e prishur dhe cregjistrimin e saj nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, sipas seksionit V te ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 26

Shnderrimi

Shoqeria mund te ndryshoje formen e vet ligjore, nepermjet shnderrimit te saj ne shoqeri aksionare. Shnderrimi nuk sjell pasoja mbi te drejtat e detyrimet, qe shoqeria ka marre persiper ndaj te treteve.

Neni 27


Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 28

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente gjykata shiptare.




Neni 29

Dispozita perfundimtare


Ky statut u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga ortaket e shoqerise tregtare " sh.p.k., nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale.

ORTAKET

FLAMUR KAIMI

Handwritten signature of Flamur Kaimi in cursive script.

KLESTA KUKUNJA

Handwritten signature of Klesta Kukunja in cursive script.